



Datë: 23.09.2025
Numër Protokolli: 6305/2025

A.nr.1248/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare e kolegjit, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë të kolegjit, më Kaltrina Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1248/2025, të datës 30.06.2025, të parashtruar nga ankuesi M.D, kundër organit të punësimit: Agjencia Pyjore Kosovare, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa A.nr.1248/2025, e datës 30.06.2025, e parashtruar nga ankuesi, M.D.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, M.D (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 30.06.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017236, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve, të shpallur më datë 20.03.2025 nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore e Kosovës, në mungesë të provave Këshilli edhe me datë 26.08.2025 ka proceduar rikujtimin e kërkesës për përgjigje në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ndërsa, kjo fundit, me datë 09.09.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi **është e pasafatshme**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të çështjes rrjedhë se organi publik – Agjencia Pyjore e Kosovës më datë 20.03.2025, ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00017236, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve, në Drejtoratet Koordinuese në Gjilan dhe Viti, me klasë të pozitës Profesional 1, një (1) vend

i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 21.03.2025 deri më datë 19.04.2025. Rrjedhimisht, në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, duke u konsideruar si kandidat që ka plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, i njëjti i është nënshtruar edhe vlerësimit përmes testit me shkrim duke ka arrit 55.2 pikë, ndërsa, në intervistën me gojë 19.2 pikë, në total 74.40 pikë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të APK-së, më datë 30.05.2025, ka publikuar Njoftimin përfundimtar me Nr.prot.1803, për kandidatin fitues nga i cili njoftim rezulton se si kandidat më më së shumti pikë është shpallur M.H me gjithsej 80.74 pikë.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit sipas konkursit publik me numër reference RN00017236, mbi pretendimin ankimor se vlerësimi i intervistës me gojë nga ana e Komisionit të pranimit nuk ka qenë meritore, pasi që, në testin me shkrim ka arrit rezultate të mira, ndërsa në intervistë me gojë është vlerësuar dukshëm më ulët, nën supozimin që ky vlerësim ka qenë për ta faforizuar kandidatin fitues që të rënditet i pari në listë. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj njoftimin për kandidatin fitues në tërsi.

Kolegji i Këshillit lidhur me kushtet për pranueshmeri të ankesës ju referua nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht, nenit 124 paragrafi 1 dhe nenit 127 paragrafi ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..., ..1. Ankesa duhet të parashetrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ., si rrjedhojë, bazuar në këtë përcaktim ligjor, si duke u nisur nga shqyrtimi i provave materiale të lëndës Kolegji konstatoi së ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse, organi i punësimit më datë 30.05.2025, ka shpallur në platformën Elektronike/SIMBNJ, Njoftimin me numër protokoli Nr.1803, si akt përfundimtar i rezultateve për procedurën e pranimit RN00017236, njoftim ky që me vet shpalljen e tij iu dërgohet në mënyrë automatike kandidateve në procedurë, ndërsa, ankuesi ankesën në KPMSHCK e ka parashtruar më datë 30.06.2025, pra, ankesa është ushtruar në ditën e 31-të pas njoftimit përfundimtar. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave ankesa është e papranueshme në kuptim të nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ndërlidhur me nenin 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1248/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, M.D;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.